

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, me seli në Takovska nr.2 Beograd Serbi, përmes personit të autorizuar Ognen Trajkovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 17.05.2023, solli

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit nga Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, me seli në Takovska nr.2 Beograd Serbi, mbi GLOBATEL d.o.o. Beograd ,Serbi, me seli të regjistruar në rrugën Mekenzijeva 24, kati 1, Beograd-Vraçar, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më datën 28.04.2023, e plotësuar më 09.05.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, me seli në Takovska nr.2 Beograd Serbi (në tekstin e mëtejshëm: Telekom Serbia), me të cilën Telekom Serbia do të fitoj kontroll mbi GLOBATEL d.o.o. Beograd ,Serbi, me seli të regjistruar në rrugën Mekenzijeva 24, kati 1, Beograd-Vraçar, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

#### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikacion kabllor, i cili gjithashtu ofron shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Telekom Serbia ka një subjekt të lidhur<sup>1</sup>, përkatësisht Shoqërinë për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup me seli në rr. Maksim Gorki 11/1-3 Shkup i regjistruar për veprimtarinë e komunikimeve me tela, gjegjësisht ofron shërbime të rrjetit publik - komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër-operatoresh, shërbime telefonike të disponueshme për publikun në një rrjet publik të komunikimit celular, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelitore.

GLOBALTEL d.o.o. është një operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimit elektronik, i notifikuar si operator celular virtual.

GLOBALTEL d.o.o. nuk gjeneron të ardhura nga shitjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik**

---

<sup>1</sup> Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me vendimin nr.08-31/2023 të datës 22.03.2023 aprovoi përqendrimin me të cilin MTEL SHPKNJP Shkup me seli në rrugën Maksim Gorki nr.11-1/kati 3, 1000 Shkup, do të fitojë kontrollin mbi kompaninë NEOTEL SHPK me seli në bulevardin Kuzman Josifovski-Pitu nr.15, 1000 Shkup

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**